



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I BIOLOGJISË

PROGRAMI I LËNDËS BIO 262

Lënda:	Histologji
Titullari/ Pedagogu i lëndës:	Dr. Blerta Laze
Ngarkesa:	Leksion 3 orë, Seminar 1 orë, Laborator 1 orë
Tipologjia e lëndës:	Disiplina të formimit karakterizues të programit
Viti akademik/ semestri kur zhvillohet:	2019-2020, Vjeshtë 2019
Lloji i lëndës:	E Detyruar
Programi i studimit:	Bachelor
Kredite:	7 kredite
Kodi i lëndës:	BIO 262
Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut:	blerta.laze@univlora.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Studentët në lëndën e Histologjisë do të marrin njohuri mbi: metodat dhe objektin e lëndës së Histologjisë, organizimin struktural dhe funksional të kater indeve kryesore, njohja me arkitekturën tipike të indeve në organet dhe sistemet kryesore të organizmit duke u ndalur edhe në analizimin e funksioneve më të rëndësishme të diferencimit qelizor.

KONCEPTET THEMELORE:

- 1 Të njihen me organizimin struktural dhe funksional të kater indeve kryesore.
- 2 Të njihen me me arkitekturën tipike të indeve në organet dhe sistemet kryesore të organizmit

TEMAT E LËNDËS:

Temat që do trajtohen në leksione:

- Tema 1** Histologjia dhe metodat e studimit. Qeliza dhe kultura indore. Indi epitelial-Tipet e qelizave.
- Tema 2** Epiteli mbulues. Epiteli gjëndror. Elementët e indit lidhor. Qelizat e indit lidhor. Fibrat e kolagenit.
- Tema 3** Tipat e indit lidhor. Kërcki dhe kocka.
- Tema 4** Gjaku dhe hematopojeza. Indi muskular.
- Tema 5** Indi nervor - Zhvillimi. Sistemi nervor.
- Tema 6** Sistemi i qarkullimit. Lëkura.
- Tema 7** Sistemi imun dhe organet limfoide.
- Tema 8** Sistemi endokrin.
- Tema 9** Sistemi tretës.
- Tema 10** Sistemi tretës.
- Tema 11** Sistemi respirator.
- Tema 12** Sistemi urinar.

Tema 13 Sistemi i riprodhimit tek mashkulli.

Tema 14 Sistemi i riprodhimit tek femrat.

Tema 15 Organet e ndijimit.

Temat që do trajtohen në seminare:

Tema 1 Hyrje në Histologji. Qeliza dhe kultura indore.

Tema 2 Indi epitelial.

Tema 3 Indi lidhor.

Tema 4 Kërcki dhe kocka.

Tema 5 Gjaku dhe hematopojeza.

Tema 6 Indi muskolor. Indi nervor.

Tema 7 Sistemi nervor. Sistemi i qarkullimit.

Tema 8 Lëkura.

Tema 9 Sistemi imun dhe organet limfoide.

Tema 10 Sistemi endokrin

Tema 11 Sistemi tretës

Tema 12 Sistemi respirator.

Tema 13 Sistemi urinar.

Tema 14 Sistemi i riprodhimit tek mashkulli.

Tema 15 Sistemi i riprodhimit tek femrat. Organet e ndijimit.

Temat që do trajtohen në laboratore:

Tema 1 Ndërtimi i mikroskopit. Parimet e punës me mikroskop.

Tema 2 Vrojtimi në mikroskop i indit epitelial.

Tema 3 Vrojtimi në mikroskop i indit lidhor.

Tema 4 Vrojtimi në mikroskop i prerjes tërthore të kockës dhe kërcit.

Tema 5 Vrojtimi në mikroskop i një strishe gjaku dhe qelizave muskulore.

Tema 6 Vrojtimi në mikroskop i qelizave nervore.

Tema 7 Vrojtimi në mikroskop i enëve të qarkullimit të gjakut dhe qelizave të lëkurës në një prerje tërthore të saj.

Tema 8 Vrojtimi në mikroskop i qelizave të sistemit imun dhe organeve limfoide.

Tema 9 Vrojtimi në mikroskop i qelizave të sistemit endokrin.

Tema 10 Vrojtimi në mikroskop i qelizave të sistemit tretës.

Tema 11 Vrojtimi në mikroskop i qelizave të sistemit të frymëshkëmbimit.

Tema 12 Vrojtimi në mikroskop i qelizave të sistemit të sistemit urinar.

Tema 13 Vrojtimi në mikroskop i qelizave të sistemit riprodhues tek meshkujt. (prerje tërthore e testikujve)

Tema 14 Vrojtimi në mikroskop i qelizave të sistemit riprodhues tek femrat (prerje tërthore e vezoreve).

Tema 15 Vrojtimi në mikroskop i qelizave ndijore.

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

Kontrolli	Vlerësimi në përqindje
Kontrolli I	25%
Vlerësimi vjetor Seminare dhe laboratore	15% (10%/5%)
Kontrolli final	60%

Vlerësimi me notë bëhet në bazë të konvertimit të vlerësimit total në %, nota 5-10 progresivisht 41-100%.

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Vlerësimi	-40	41-50	51-60	61-70	71-80	81-90	91-100

FREKUENTIMI:

Studenti, që rezulton më pak se 75% frekuentim për periudhën që i përket cdo provimi të pjesshëm, periudhë për të cilën do të testohet, nuk do të futet në provimin përkatës, do të vlerësohet me M. Nëse studenti ka frekuentuar kursin, por nuk paraitet në provimin e radhës vlerësohet NP (Nuk u Paraqit).

FORMATI I LËNDËS:

Lënda do të vlerësohet mbi bazën e një kolekiumi, detyrave si dhe provimit final. Pikët e marra do të jenë kumulative. Nuk do të ripërsëriten provimet, për asnjë motiv. Nëse ju do të humbisni një provim pa ndonjë arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim në të cilin nuk u paraqitët.

KOMUNIKIMI:

Ushtrimet e detyrave të shtëpisë, detyra e kursit dhe çdo njoftim tjetër do të jepet në klasë ose në adresën zyrtare të Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës në internet: www.univlor.edu.al apo në adresën elektronike të pedagogut blertalaze@univlor.edu.al

Email: Çdo student e ka për detyrë të kontrollojë rregullisht e-mailin. Detyrat dhe njoftimet do të jepen vetëm nëpërmjet e-mailit.

KODI I NDERSHMËRISË:

Studentët inkurajohen të punojnë edhe në grupe për ushtrimet e detyrat që u jepen. Nuk lejohen kopjimet nga njeri-tjetri në provime, për detyrat e kursit, të shtëpisë, etj. Thyerja e këtij rregulli do të shoqërohet me masa ndëshkimore që shkojnë deri në përjashtimin e studentit nga universiteti.

LITERATURA

a) **Literatura bazë e detyrueshme:**

“Histologjia”, M. Lika (Çekani)

b) **Literatura e rekomanduar:**

2. Histology and Cell Biology (fifth edition)

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Ushtrimet e detyrave të shtëpisë, detyra e kursit dhe çdo njoftim tjetër do të jepet në klasë. Studenti duhet të kontrollojë rregullisht e-mailin sepse do të ketë detyra dhe njoftime që do të jepen nëpërmjet e-mailit.

Studentët në këtë kurs duhet të lexojnë, të realizojnë detyrat të cilat do të kontrollohen rregullisht.

Detyrat e shtëpisë do të vlerësohen jo vetëm si sasi por edhe nga cilësia e zgjidhjes së tyre. Studentët inkurajohen të punojnë edhe në grupe për ushtrimet e detyrave.

Frekuentimi i seminareve dhe leksioneve detyrohet deri në 75% të orëve. Numri i mungesave mbi 25% përjashton studentët nga pjesëmarrja në provim.

Nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë dhe pirja e duhanit në auditor.

PEDAGOGU I LËNDËS

Dr. Blerta Laze

.....